



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 19.01.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.01.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Rojet E Nderit "SH.P.K.,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës “ , Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-052-211, nxjerr:**

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Rojet E Nderit "SH.P.K,** e dt.17.01.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës “ , Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-052-211,** kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 13.01.2023, në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë 13.01.2023

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Rojet E Nderit "SH.P.K.,** me dt.17.01.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Rrënimi- Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës “ , Nr. i prokurimit- 632-22-6005-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-052-211.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 19.01.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik "Rojet E Nderit "SH.P.K,, të dt.17.01.2023, Autoriteti kontraktues, sqaron se :

ROJET E NDERIT

151424 orë pune x 2,15€ (1 orë pune) = 325.561,60€

325.561,60€ : 24 muaj = 13.565,07€

13.565,07€ : 38 punëtorë = 356,97€

Sipas analizës Juaj

Paga neto për 1 muaj	280,00€
Tatimi në burim	10,00€
Trusti pensional 5% i punëmarrësit	15,26€
Trusti pensional 5% i punëdhënësit	15,26€
Fitimi për punëtorë	0,15€
Gjithsej kostoja për një punëtorë dhe kontributet	320,67€
Kostoja për një punëtorë pjesëtuar për 176 orë pune	1,82€
TVSH-ja (18%)	0,33€
Çmimi përfundimtar me TVSH për një orë pune	2,15€

Analiza e Autoritetit Kontraktues

Paga neto për 1 muaj	280,00€
Tatimi në burim	10,00€
Trusti pensional 5% i punëmarrësit	15,26€
Trusti pensional 5% i punëdhënësit	15,26€
Fitimi për punëtorë	0,15€
Total pagesa për punëtorë	320,67€
Numri i punëtorëve	38 punëtorë
Muaji	24 muaj
Fitimi mujor për total	5,70€
Paga mujore (320,67€ x 38 punëtorë)	12.185,46€
Pagesa për 24 muaj	292.415,04€
TVSH-ja (18%)	52.634,71€
Gjithsej totali	345.049,75€

Nga kjo rezulton se pretendimi juaj është i pabazuar , sepse oferta juaj ka kaluar vlerën e parashikuar dhe ka ndryshim në çmim mbi 2%.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;